



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1578/1 Prot

Tiranë, më 08.11.2019

V E N D I M

Nr.125, datë 08.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Vlorë të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vlorë,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me Urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Vlorë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka

rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Vlorë, me Vendimin nr. 133, datë 20.12.2018, “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara-2019”, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Vlorë dhe njësisve administrative e institucioneve në varësi të saj. Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Vlorë, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ka nxjerrë Vendimin nr. 37, datë 01.07.2019, “Për shtesë dhe disa ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2019”. Kjo strukturë dhe organikë është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Vlorë sëbashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **104** pozicione pune të vlerësuar si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **11** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese; **6** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **87** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **92** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **2** pozicione të shërbimit civil, rezulton se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe josipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **10** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende vakant.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, bëhet fjalë për **2** punonjës “Specialist të QKB-së”, evidentuar si më poshtësi edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, punonjëse “Specialist i nivelit të lartë”, në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit të Bashkisë Vlorë, emëruar me Vendimin nr. 44, datë 03.04.2008, “Për emërimin në detyrë të punonjësve të Bashkisë Vlorë”.
2. *****, punonjës “Nëpunës i sportelit të QKR”, në Bashkinë Vlorë, emëruar me Aktin nr. 7, datë 24.04.2014, “Për emërimin në detyrë të punonjësve të Bashkisë Vlorë”.

Komisioneri ka mbajtur qëndrim për këto pozicione pune në lidhje me përfshirjen e këtyre pozicioneve si pjesë e shërbimit civil, dhe pasi ka analizuar bazën ligjore që rregullon marrëdhënien e punës për këto pozicione, ka rezultuar se:

Neni 2, “Fusha e veprimit”, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikon fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, duke parashikuar shprehimisht:

“Ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim “nëpunës civil”), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore...”

Referuar nenit 4, germa c), “Përkufizime”, të këtij ligji, me termin nëpunës civil do të kuptojmë:

“Nëpunës civil është personi që kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre”.

Në këtë kuadër ligjor, për trajtimin e rastit, ndalemi në parashikimet ligjore, të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, për kategorizimin e punonjësve të sporteve të shërbimit të QKB-së, që ushtrojnë funksione të deleguara, të cilat konkretisht, janë parashikuar në nenin 8, pika 1, të tij, si më poshtë vijon:

“Nëpunësit e sporteve të shërbimit, të hapura nga QKB-ja, sipas pikës 3, të nenit 4, të këtij ligji, janë nëpunës civilë të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore”.

Referuar sa më lart, në pikën 3, të nenit 4, “Organizimi dhe sportelet e shërbimit të QKB-së”, të këtij ligji, është sanksionuar se:

“QKB-ja ofron shërbim në territor, nëpërmjet sporteve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore, si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. QKB-ja lidh marrëveshje bashkëpunimi me njësinë e qeverisjes vendore, ku përcaktohen kushtet e ofrimit të shërbimit dhe treguesit kryesorë të performancës, kualifikimet dhe kriteret e posaçme profesionale të nëpunësve të sportelit, si dhe trajnimet e detyrueshme për nëpunësit”.

Pra, sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara, punonjësit e QKB-së që ushtrojnë funksione të deleguara pranë njësive të qeverisjes vendore, trajtohen si nëpunës civil pranë këtyre njësive.

Me tej, në nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 131/2015, “Për qendrën Kombëtare të Biznesit”, parashikohet se:

“Niveli i pagave dhe i shpërblimit, si dhe numri i nëpunësve apo punonjësve të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 8, të këtij ligji, përcaktohen në përputhje me

legjislacionin në fuqi, përkatësisht, nga njësitë e qeverisjes vendore apo subjektet e tjera, me të cilat QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi”, e që në rastin konkret bëhet fjalë për Bashkinë Vlorë.

Duke qenë se, punonjësit në pozicionin e punës “*Specialist*”, pranë njësive vendore janë trajtuar si nëpunës civil, në përputhje me ligjin 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, kjo nënkupton seçdo marrëdhënie e re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, kërkon të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Pasi çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, është parashikuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku citohet se:

“Çdo emërim në pozicion ekzekutiv, në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm”.

Nisur nga parashikimi ligjor i sipërcituar, njësia përgjegjëse duhet që të marrë të gjithë hapat e nevojshëm në respektim të ligjit procedural e material, për ti trajtuar punonjësit e sporteleve të shërbimit të QKB-së pranë Bashkisë Vlorë, si nëpunës civil mbështetur në ligjin nr.131/2015, “*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*”, në ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kreun IV, “*Pranimi në shërbimin civil*”, si dhe Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Për këtë arsye, njësia përgjegjëse duhet të deklarojë statusin e punësimit për dy punonjësit e përmendur më lart, të cilët deri në këtë moment nuk janë trajtuar si punonjës pjesë e shërbimit civil.

Gjatë verifikimit në këtë institucion, rezulton se, pranë Bashkisë Vlorë janë 10 pozicione të lira pune, konkretisht, bëhet fjalë për 2 pozicione niveli mesëm drejtues dhe 8 pozicione të nivelit ekzekutiv (*Specialist*), për disa nga këto pozicione mungon përshkrimi i punës.

Në këtë rast njësia përgjegjëse, të vijojë hartimin e përshkrimeve të punës për rastet kur është konstatuar mungesa e tyre, duke respektuar standartet e përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të*

pavarura”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 31.05.2017, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, të DAP.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të përfshijë në kategorinë e nëpunësve civilë 3 pozicionet e punës “*Specialist i QKB-së*” dhe në zbatim të nenit 67, të ligjit 152/2013, të deklarojë statusin e punësimit për 2 punonjësit:

1. ***** , punonjëse “*Specialist i nivelit të lartë*”, në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit të Bashkisë Vlorë, emëruar me Vendimin nr. 44, datë 03.04.2008, “*Për emërimin në detyrë të punonjësve të Bashkisë Vlorë*”.
2. ***** , punonjës “*Nëpunës i sportelit të QKR*”, në Bashkinë Vlorë, emëruar me Aktin nr. 7, datë 24.04.2014, “*Për emërimin në detyrë të punonjësve të Bashkisë Vlorë*”,

të cilët deri në këtë moment nuk janë trajtuar si nëpunës civilë të emëruar në pozicion pune të shërbimit civil.

2. Njësia përgjegjëse të përfundojë procesin hartimit të përshkrimeve të punës, për ato pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në të cilat mungojnë, dhe të vijojë procesin i plotësimit të pozicioneve të lira, në zbatim të kërkesave të ligjit dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të paralajmërimit.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 (dy) muaj** nga marrja dëgjimi për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vlorë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

4. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Vlorë, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Vlorë. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Vlorë duhet të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim për detyrat e lëna në dispozitivin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha